

Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tiranë, datë 19.04.2023

Kryetari i Bashkisë Tiranë Z. Erion Veliaj: “Shumë faleminderit Vjollca, shumë faleminderit të gjithëve. Gëzuar Rominës, kryetares së këshillit bashkiak, ditëlindjen, dhe shumë faleminderit secilit që është këtu sot në këtë takim, ndoshta të fundit, përpara se të kemi vendim marrjen e popullit të Tiranës për mënyrën se si do të vazhdojmë përpara në 4 vitet e ardhshme.

T’ju falënderoj për te gjithë angazhimin dhe për te gjithë impenjimin edhe seriozitetin në këtë punë, që është një mision shumë i rëndësishëm për qytetin tonë.

Kur dëgjoj kundërshtarët tanë, këta non-grata-t dhe këta fuksat e sigurimin që thonë:” Nuk dimë kush janë anëtarë të këshillit bashkiak”, kam kohë që pres tu jap një përgjigje - s’keni si ta dini se ju ikët nga këshilli bashkiak, ju dezertuat. Shoh aty doktor Glozhenin, n.q.s. doktor Glozheni ose kushdo doktor tjetër nuk shkon 4 vjet në punë, sigurisht që s’do thoshte dot “Nuk i njoh punonjësit e tjerë të maternitetit”, madje as nuk do guxonte të kthehej me ne profesion kur për 4 vjet, ka lënë, ka braktisur detyrën. Shoh Redi Jukën aty, n.q.s. një futbollist 4 vjet i bën gola skuadrës së vet, ose ikën nga fusha e le lojën, gjasat janë që askush nuk te merr me ne një skuadër kur ke reputacionin konstant të braktisjes. Shoh Redjanin këtu, Redjani është avokat. N.q.s. Redjani 4 vjet nuk i shkon klientëve nëpër gjyqe, gjasat janë që asnjë njeri nuk do të dojë të punojë me një avokat që për 4 vjet braktisi detyrën. Shoh profesor Civicin që n.q.s. nuk shkon 4 vjet në fakultet të japi mësim, askush nuk do të marri më një profesor i cili për 4 vite, braktis detyrën dhe nuk shkon te detyra e vet. Kjo vlen për secilin prej roleve tona, **kështu që kjo duhet të vlejë tani dhe për Ilir Metën dhe Saliun.**

Të thuash që nuk njeh anëtarët e këshillit bashkiak; së pari detyra e këshillit bashkiak nuk është që të njihet, është që të shërbejë, dhe këtë detyrë e ka kryer më së miri dhe në ditët e pandemisë, edhe kur ishim në karantinë, edhe në ditët e tërmetit, edhe në ditët e inflacionit të luftës që duhet te merrnim shumë vendime për subvencionimet dhe për shumë punë të tjera që bëme, sikur ishte ajo e subvencionimit të abonesë, që ne e paguajmë 100% për studentët, gjysmën e konvikteve.. Ti nuk mund të njohësh njerëz n.q.s. nuk shërben me ta, n.q.s. nuk punon me ta, dhe në politikë vendet ku ti shërben janë Këshilli Bashkiak edhe parlamenti. N.q.s. ti e braktis këtë detyrë dhe kujtohesh pas 4 vitesh dhe thua pse nuk i njof, nuk i njeh se s’ishe në punë, nuk i njeh se nuk ishe aty kur qyteti, vendi, kishte nevojë për vendimmarrjen tënde. Ndaj dhe në këtë sens, ju falënderoj me të vërtete, edhe **besoj që publiku do të na japë një përgjigje vendimtare, siç po thonë gjithë sondazhet**, njerëzit që braktisin detyrën... N.q.s. ne nuk tolerojmë një ushtar, një polic të dezertojë, se ndryshe dënohet, nëse ne kemi një stekë shumë të lartë për nxënësit dhe për fëmijët e fillores, që jo 4 vjet, jo 4 muaj, jo 4 ditë, jo 4 orë, po 4 minuta të vijnë nga zilja e parë dhe marrin mungesë. Dhe ne e kemi stekën këtu për nxënësit, për fëmijët tanë, dhe për çdo profesion tjetër, ndërkohë e kemi shumë stekën poshtë për politikanët, që kujtohen pas 4 viteve dhe thonë kush janë anëtarët e këshillit bashkiak. Por inshallah vazhdojnë si e kanë nis, se dhe në këtë këshill bashkiak nuk do marrin pjesë me mendtë që kanë.

Por për sa kohë që ne e kemi këtë detyrë, këtë mision, këtë privilegj, për ti shërbyer publikut të Tiranës, deri ditën e fundit që ky këshill; edhe ju falënderoj që jeni të gjithë këtu sot; deri ditën e fundit që ky këshill është betuar që të shërbejë, do vazhdojë që të shërbejë. Kështu që dua ti marr me radhë vetëm për t’ju bërë disa shpjegime për vendimet e sotme.

Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tiranë, datë 19.04.2023

Vendimi i parë ka të bëjë me një politikë sociale që ka ndjekur bashkia e Tiranës, edhe po të shikosh vendimi sot është modest, krahasuar me sa vendime kemi marrë. Pse e them që është vendim modest, për të treguar që nuk bëjmë gjë për fushatë, ne 99% të këtyre vendimeve i kemi marrë deri më sot. Por për sa kohë që jemi në detyrë, do vazhdojmë të marrim vendime të tjera. Pra n.q.s. vendimi sot për bonuset e strehimit është për 38 familje, dua t'ju kujtoj që në total, nga të tërë këta këshilltarë që nuk i njeh **fuksi i lagjes Ilir Meta dhe ish komunisti Sali Berisha**, janë marrë vendime strehimi për 6.127 familje, që kanë emër, që kanë mbiemër, që kanë halle, që kanë pasur fatkeqësi e tragjedi e vaki e lloj lloj problematikash, po që kanë ardhur, janë adresuar këtu mbi 6127 raste.

Ndërkohë, kemi ndihmuar 3651 kredi të buta në këtë mandat, ku njerëzit thonë “kush i merr këto” janë të gjithë, dhe ju kujtoj, që në bashkinë që gjetëm këtu, ishin të gjithë zv. ministra, të gjithë drejtorë, dhe gardistët e 21 Janarit. Ndërkohë na rezultoi që janë 3651 kredi të buta, pra, 3651 apartamente që janë blerë vetëm falë kontributit të bashkisë së Tiranës për familjet e reja. A është ky një qytet që po rritet vlera e pronës? Absolutisht që po. A është kjo një gjë e mirë? 100% po. Imagjinoni një pronë që vlente €100.000 në vitin 2015, sot mesatarisht vlen €250-300.000, është rritur me 2,5-3 herë sipas INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë. Për të gjithë kritikët që thonë që kjo është gjë e keqe, atëherë i pyes kritikët, po nëse prona juaj do vlente €100.000 në 2015 dhe tani do vlente €50.000, kjo është gjë e mirë apo e keqe? Se kur vlen 2.5 ose 3 herë më shumë, ke mundësi të paguash njëherë bankën për njëqindëshen që more kredi atëherë, dhe tani që e ke 2.5-3 herë më të lartë, mund të futesh në një tjetër investim, se tashmë ke dhe para që të kanë mbetur nga investimi i parë. Kështu që është shumë e rëndësishme që ne të artikulojmë që patjetër që rritja e vlerën së pronës 93% të tiranaseve, që janë pronarë, i ka bërë sot më të pasur, si një qytet më të pastër, me më shumë aktivitete, me më shumë turizëm, me më shumë reputacion, me më shumë ndriçim, me më shumë rrugë, me më shumë parqe, sigurisht që rritet vlera e pronës në një qytet.

Pse s'është rritur vlera e pronës në Shkodër, e keni bërë ndonjëherë pyetje vetes? Ja një qytet që e menaxhojnë ata, na thotë sa është rritur vlera e pronës në Shkodër, dhe kush është gati të shesi shtëpinë në Tiranë, dhe të blejë në Shkodër sot. Si ka mundësi që, në 100 blerje, 99 janë me këtë vektor, nga Shkodra në Tiranë, jo nga Tirana në Shkodër. Sepse raporti është 99-1, si një vlerësim që njerëzit kanë për dy filozofi të qeverisjes.

Sot ne kemi 8 qendra sociale të transformuara totalisht. Ishim me Elvanën, dhe me të drejtë, Elvana Gjata tha: “Unë nuk e dija që ne kishim qendra sociale”. Ajo në fakt s'ka nevojë ta dijë se nuk është te kategoria e njerëzve në nevojë. Por për të gjithë ata njerëz që janë në nevojë dhe dinë ku janë këto shërbime, prape dita me natë. Është shumë kollaj n.q.s. ke qenë në pandemi, n.q.s. ke qenë në tërmet dhe rrije tërë kohën te Gjiri i Lalzit, është shumë kollaj të thuash që nuk është bërë asgjë. Por për këtë këshill që i ka marrë këto vendime, ka bërë këtë pagese, ka bërë këto investime, më beso që duhet ti themi të vërtetat ashtu siç janë, dhe sot në këto 8 qendra sociale, kemi 3.500 persona që u shërbejmë çdo ditë, jo vetëm me ushqim, se njeriu s'jeton vetëm me bukë, por edhe me ndihmë psiko-sociale, edhe me logoped, edhe me psikiatër, edhe me punonjës socialë që kryejnë disa ndihma dhe disa nevoja për të moshuarit e vetmuar, edhe me infermierë dhe me parainfermierë kur kanë dhe çështje shëndetësore. Ndaj dhe sot vendimi për 38 familje të reja që marrin, është vlerësuar nga komisioni i strehimit me dokumentacion të plotë, dhe gjendja faktike, përfitojnë një shumë totale prej 659 mije leke, pra thuhet 700 mije lekë në muaj, janë familje me nëna kryefamiljar, familje me anëtarë me aftësi të kufizuara dhe pension invaliditeti, individë të

Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tiranë, datë 19.04.2023

moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit, viktima të dhunës në familje, apo familje që kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore, zjarreve apo vështirësive ekonomike në familje, banesat e të cilëve prishen apo përjashtohen nga proceset e legalizimit, si rezultat i investimeve publike. Kështu që janë dhe 8 familje të cilat e kanë patur aplikimin të pjesshëm, dhe duke qenë se këto familje e kanë të pjesshëm, u është lënë dhe një muaj kohë ta plotësojnë, dhe pastaj ndoshta bëjmë dhe ndonjë vendim shtesë, ku kësaj 38 që kalojmë sot, shtohen dhe 8 të tjera.

Ndërkohë, për banesat sociale, kemi disa hapësira shtesë te banesat sociale, kështu që ne sot bëjmë edhe një thirrje për më shumë apartamente te banesat sociale, kështu që miratojmë dhe sistemin e pikëzimit për përfituesit e programit. Sistemi i pikëzimit është një sistem transparent ku ti, sipas nevojës merr ca pikë të caktuara, dhe ne sigurohemi që ata që janë vërtetë nevojtarë futen në banesat sociale, kështu që do ju kërkoj që të marrim dhe këtë vendim sot. Ju kujtoj që e filluam këtë punë dukë shpërndarë banesa sociale, të cilat as nuk i ndërtoan vetë. Ishin ndërtoar në kohën e Edi Ramës, ndenjen 4 vjet, u desh ti shpërndanim. Pra dhe për të shpërndarë punën e dikujt tjetër u deshën të ndërhynin sepse ishte e pamundur. Një bashki që e gjetëm në gjumë, dhe kush mban mend këtu, shkuam në kat të dytë, banja VIP e kryetarit të bashkisë me fuçi uji e sapllake, pra dita me natën.

Kur dëgjon këta që thonë “Do rikthehem i do marrim bashkinë e Tiranës”. Këta e kishin bashkinë e Tiranës, këta s’kishin ujë. Adresa nr. 1 në Republikë që është sheshi Skënderbej nr. 1, kilometri 0 i Shqipërisë, fillojnë maten gjithë distancat nga këtu, ishte pa ujë. Sot diskutojmë sa orë ka bërë Shën Gjergji, patjetër që do ti bëjmë ato diskutime, por nuk diskutohet më bashkia e Tiranës, torta, qendra dhe sapllakja me ujë në banjën VIP të bashkisë. Në këtë sens, për banesat sociale sot, marrim këtë vendim të pikëzimit, dhe pastaj për të gjithë kontingjentin e banesave që janë në dispozicion, ne do të bëjmë një thirrje dhe do të administrojmë aplikimet aty.

Ndërkohë, kemi një projekt vendim për pagesat e qirasë sipas vlerës së tregut për individë, familje që janë prekur nga shpronësimi për interes publik, pra, këtu bëhet fjalë për dy zonat e reja në kombinat, në njësinë administrative 4 edhe 8, që quhet si zona e 5 Majit, atje ku ishim me disa prej jush, në atë ecjen dhe vizitën që bëmë në komunitet.

Në fakt, në të dyja zonat ne kemi ecur me shpejtësi të ndryshme, jo ashtu siç do të doja unë të kishim ecur dhe siç do të donte këshilli bashkiak. **Në zonën e kombinatit kishim përballë LSI-në, e cila, duke qenë se është parti gjithmonë e më shumë në tkurrje,** zgjodhi që betejën ta bënte ligjore, duke përdorur gjykatësit për të na bllokuar me masa, sigurim padie, që të mos ecte puna, dhe sot me kënaqësi, dhe me trishtim se humbëm kohë, por me kënaqësi mund të them që i kemi fituar të gjitha gjyqet me Monikën dhe me ____ e saj që donte Kombinatin. Dhe tani keni vënë re që janë 10 pallate duke u ndërtoar në kombinat, fillon dhe bateria tjetër me 10 të tjera. Ndërkohë që - **se nuk e di si quhet kjo pjesa e Saliut, se që nga ai momenti traumatik i lënies vetëm të pensionistit 80 vjeç në mes të stadiumit me karriget bosh,** por sido që të quhet kjo copa e Saliut, se Partia Demokratike është një parti tjetër), zgjodhi të na bllokonte te 5 Maji, duke përdorur lloj lloj kontingjenti te OFL-së, dhe duke qenë se ata kanë gjithsesi pak më shumë numra se **partia e lekut dhe e rublave,** ata zgjodhën ta bënin këtë me dhunë dhe me forcë. Por, me dhunë dhe me forcë, gjithsesi, zgjidhet më kollaj se janë organet e rendit, dhe aty punuam çik më shpejt, se sa bllokimet në gjykatë që na zgjatën më shumë.

Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tiranë, datë 19.04.2023

Lajmi i mirë është që po punojmë në të dy kantieret, te 5 Maji, pjesa më e madhe e familjeve janë futur, këtu bëhet fjalë për të kaluar kontrata kompensimi për ata që e kanë me shpronësim. Pra nuk u prekëm nga tërmeti, por kishin ndërtuar te toka e bashkisë te 5 Maji. Ne nuk u bëmë atë që ndodhte më përpara, **ku këta të vinin ruspën dhe të linin pa trajtim**; ne thamë, edhe për ju që jeni ndërtues pa leje, në tokën tonë, në tokën e bashkisë, të qytetit, të publikut, pavarësisht situatës, ne do t'ju japim kompensim metra katrorë, dhe deri në atë fazë, ne do paguajmë për 3 vite qiranë. Kështu që këtu bëhet fjalë për të shtuar listën edhe me disa familje të tjera që do të marrin qiranë 3 vjeçare, për tu siguruar që dhe personat që ishin në atë territor të bashkisë dhe pse pa leje, te kompensohen fillimisht me qira, dhe pastaj të marrin metrat katrorë si gjithë të tjerët, që nga ky proces rindërtimi, askush të mos ngelet pas, dhe secili të ketë një mundësi për një jetë më të mirë. Dhe me këtë rast urbanizohen dhe ata që jetonin në breg të lumit, ku falë investimit tonë, lumi nuk përmytet më, por dhe ato kushte spartane s'kanë pse vazhdojnë më. Me rastin e tërmetit marrin shtëpi dhe ata të tërmetit, dhe ata që jetonin te buza e lumit. Të njëjtën gjë duam të bëjmë tani me vendimin tjetër, që ka të bëjë me miratimin e bonusit të qirasë për individë dhe familje, pasuritë e të cilëve preken nga zbatimi i projektit të segmentit rrugor unaza e madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja, bulevardi i ri, Shkozë.

Tani, këtu bëhet fjalë për gjysmën tjetër të unazës. Ju kujtohet që ndalëm 3 vjet Astirin, ata që sot na fyejnë inteligjencën dhe bëjnë sikur janë shqetësuar për Astirin, ku për ne, fakti që 200 lagje të Tiranës, 197 i kanë zgjidhur problemet e shkollave dhe na ka ngelur dhe dy shkollat e Astirit, që do shkoj fizikisht të prezantoj sheshet që më në fund i kemi fituar në gjykatë, dy te Liqeni i Thatë dhe dy në Sauk, ne i zgjidhim përfundimisht edhe për këto tre lagjet e fundit, çështjen e arsimit. Por, kur kujton që Astiri ishte pjesë e Kasharit edhe e merrte ujin nga puset e Coca-Cola të Laknasit, investimi që bëri ky këshill bashkiak që të vinte një linjë e dedikuar nga Bovilla e deri te Astiri, s'duhet harruar, e duhet kujtuar. Fakti që **banorët aty votojnë mbi 65% këtë fuqi transformuese, do të thotë që ata janë shumë të qartë kush bën punë**, kush bllokoi. **Të ngresh dy gishtat lart te Astiri dhe të thuash kjo është vijë e kuqe dhe partia jonë do shtrihet barkas këtu, ishte humbje kohë për të gjithë**, jo vetëm për socialistët, edhe demokratët. Sot te ajo rrugë kalojnë të gjithë! Sot ajo rrugë i ka dhënë vlerë të gjithë, të shikosh tani nga ana e Lanës që konsiderohej pjesa më e degraduar, të shikosh si po lulëzon investimi dhe urbanizimi i asaj hapësire. Kështu që **shpresoj shumë që pas 14 Majit, kjo kultura që ne 4 vjet e trajtojmë çdo ditë si fushatë, ka fushatë, mbaron fushata, kush fiton, duhet të bëjë punët që ka marrë përsipër**.

Kështu që në këtë sens, bëhet fjalë tani për gjysmën tjetër të unazës, dhe tani po flasim nga Shqiponja në drejtim të lumit të Tiranës, kalon të Bulevardi i Ri, futet prapë te 5 Maji, del në Tufinë, dhe bashkohet në Farkë të madhe aty ku janë helikopterët dhe aty ku ka ardhur nyja, le të themi pjesa lindore e unazës, tani duhet bërë dhe pjesa perëndimore. Kështu që sot, me këtë vendim, miratojmë bonusin e qerasë 3 vjeçar për ato familje, sërish po e them, pavarësisht se ishin në gjurmën e Astirit ose të Unazës që në kohën e Ardit Çarçanit, kjo qeveri dhe kjo bashki vendosi për personat që preken ka 2 mundësi, ose pagese cash sipas vlerësimit për metër katror, ose vlerësim për metër katror. Kështu që, pavarësisht se çfarë zgjedhim familjet, ne 3 vjet u japim qiranë, dhe pastaj në varësi të kontratës që ata bëjnë, o ju japim metra katrorë për banesë, o ju japim pagesën e tyre.

Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tiranë, datë 19.04.2023

Ndërkohë kemi një vendim tjetër, që ka të bëjë me një spostim të një terreni për dhomën e avokatisë. Dhoma e avokatisë, duke qenë se i liroi KLP-së dhe KLGJ-së hapësirën e vet që është te fusha e aviacionit, mori kompensim prej qeverisë sonë dhe bashkisë së Tiranës, një tokë në Qytet Studenti. Duke qenë se paralelisht ndërsa u mor kjo tokë 4.900 metra katrorë, që ti lirojë KLP-së dhe KLGJ-së hapësira te fusha e aviacionit, kjo tokë paralelisht ishte pjesë e një studimi për kampusin universitar të Qytetit Studenti, ka lindur nevoja vetëm për një spostim, por do të jenë koordinatat fikse. Nuk na prish asnjë punë me filozofinë e kampusit të studentit, sepse aty do të transferohet dhe fakulteti juridik.

Fakulteti juridik në mes të bllokut i ngjan një gjimnazi të viteve '60-'70, siç ishte dikur Sami Frashëri e Partizani. Por nuk është në kushtet e një hapësire me aula dhe me salla dhe me të gjithë komoditetet. Kështu që dhe fakulteti juridik na ka kërkuar të jetë aty, dhe praktikisht, dhoma e avokatisë, fakulteti juridik, disa nga fakultetet e tjera që do të transferohen në kampusin e ri, rrinë fare mirë bashkë, sepse duam që kampusi mos të jetë vetëm një konvikt për të fjetur edhe për të kryer nevojat bazë, por të jetë një ambient ku edhe jetohet, edhe shkohet në shkollë, kur ke një pushim edhe kthehesh dhe pushon pak, po ka dhe biblioteka, ka dhe kinema. Pra, i gjithi të funksionojë si një qytet studentor.

Kështu që në këtë sens bëhet fjalë, për ti kthyer përgjigje qeverisë për koordinatat ekzakte që të mos ketë mbivendosje të dhomës së avokatisë, me të gjithë investimet që ne duam të bëjmë në Qytetin Studenti.

Kjo pikë është ndoshta pika më e rëndësishme që kam për diskutimin e sotëm, që ka të bëjë me miratimin dhe tërheqjen e shpërndarjes së përqëndruar të biletave të trajtimit mujor, ose ajo që quajmë abone për transportin qytetas në bashkinë e Tiranës. Çfarë ndodh: një shprehje amerikane thotë “kur vjen cirku në fshat, dalin gjithë kllounët e fshatit që ta përshëndesin”, pra kur vjen fushata, **lloj lloj mitomani dhe injoranti del dhe fillon nga këto çudirat, jo po transporti falas, jo po sa do kursesh, do kursesh 50.000 – 52.000 lekë për person.** Aboneja është 16.000 lekë, pra, po flasim me të vjetrën. Pra si mund të kursesh më shumë se sa shpenzon, se kjo s'ka logjikë. Sot aboneja; ti mund të udhëtosh në të gjitha linjat, për 1.600 lekë të reja. Nëse do udhëtosh vetëm një linjë është 900 lekë. Kështu që kjo historia e mbledhjes së 40 lekshave, ndërkohë që nuk e dinë që në Tiranë ekziston një abone, për ata që janë realisht përdorues të shpejtë të transportit, është shumë shumë herë më e lirë. Së dyti, **ka dështuar transporti falas kudo, është bërë falas pa pikë diference në përdorim, vetëm në ato vende që tashmë e kishin subvencionimin 90 e ca përqind.** Luksemburgu, kryetari i bashkisë që sot është kryeministër më tha “Ne e kishim 97% subvencionimin, nuk ja vlente marrja e biletave për atë 3% se na shkonte më shumë mbledhja e biletave, printimi, shpërndarja, shitja, kalkulimi. Pra kostoja administrative ishte më e madhe se ky 3%. Kështu që në atë moment thashë në djall, më mirë e bëjmë 100%, sepse që nga koha e sindikatave pas luftës, ishte shumë i subvencionuar.” Në Talin, s'po e them ku shkoi kryetari i bashkisë, po nuk i eci puna mirë, sepse ngaqë zhvendosi të gjithë buxhetin e bashkisë për të bërë transportin falas, sepse atje njerëzit e hëngrën rrenën, siç hëngrën dhe këtu tramin, dhe zbuluan që zhvendosja e gjithë financave të bashkisë vetëm në një premtim, bëri që bashkia të mos bënte as një shkollë, as kopsht, as çerdhe, dhe që sigurisht mbaroi dhe karriera e atij lumëmadhut në Talin. Edhe sot konsiderohet si një nga gafat më të mëdhaja, sepse as nuk e rriti përdorimin e transportit publik.

Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tiranë, datë 19.04.2023

Ju si mendoni, që një njeri në kohën e krizës e ka naftën 2.000 e ca lekë do joshet nga 40 lekshi, pra për 40 lekëshin nuk po lë makinën me 2.000 lekë. Se po të ishte kështu që tani është më atraktiv. Jo sepse ai që ka makinë ka thënë “Do shpenzoj më shumë sepse më intereson komforti i vajtjes nga A në B, në distanca të largëta dhe jashtë, ndoshta, rrugëve kryesore me makinë, dhe jam gati ta paguaj. Dhe ne Talin, nuk lëvizim as 1% transporti. Bashkia bllokoi gjithë fondet e veta, dhe ndërkohë e la rrugës. **Ka një teori tjetër, që thonë “Ne ç’a ti bëjmë që s’e kemi bashkinë, se po të kishim bashkinë, ju aprovonim si bëhen këto gjërat falas. Dhe unë them, po, na e provoni në Shkodër.** Shkodra ka një linjë autobusi, ne kemi 20 në Tiranë dhe 19 ndërqytetëse, pra që vijnë nga ish-komunat. Kështu që ne kemi 39 linja, ata një linjë kanë nga Bahçallëku, deri në Vigu e pastaj kthehet prapë, pra bën vetëm një xhiro. Tani, këta me një linjë, pse nuk e bëjnë dot falas, të na e tregojnë e të thonë “ore siç e qamë ne, Shkodrën, ashtu do bëjmë dhe Tiranën”.

Nejse, kur e pyesin kryetarin e bashkisë së Shkodrës, ai jep një përgjigje dhe thotë “**Nuk mposhtet shpirti demokratik i Shkodranit**”. O vëllai, po të pyesim për tabelë Excel-i, sa të del llogaria, bëje ti meqë **Saliu dhe Iliri paskan këtë program kombëtar për çdo gjë falas, duke prezumuar që ne e harruam Sudan, tortën, disko-krokodilin te parku rinia, dhe Lanën, që tani propozohet me shezlong, dhe ne e pamë se çfarë i bënë ata Lanës kur e kishin në dore, na e tregoni si bëhet kjo në Shkodër me një linjë, jo më me 39. Teoria tjetër, ne nuk kemi mundësi thotë, se ne i kemi taksat me të ulëta në Tirana, duke qenë se jemi kryeqyteti, European, kryeqyteti i trameve, me taksat më të ulëta në Republikë. Dhe unë, apriori, unë i pari, dhe unë e kam ngrënë këtë, pra dhe unë i pari mendova “rrezik kështu janë vërtet, d.m.th. me na bo karshillik.**

Pse ka këto tensione, e majta e djathta; ata rrezik i thashë i kanë të ulëta. Dhe unë prej shumë vitesh e besoja këtë gjë. Pra e besoja që **në këtë karshillikun ndaj qeverisë dhe maxhorancës, këta vërtetë i kanë aq të ulëta sa nuk përballojnë dot.** Por në një moment thashë ore, pse nuk e kontrolloj vet unë këtë.

Edhe marr dy fatura, UKT-ja dhe UKSH-ja, ku mblidhet taksa e bashkisë të Shkodrës. Taksa dhe tarifa familjare, dhe nuk e thotë, pa specikime të saj; 708 lekë, 7.000 për familje, pa e specifikuar për çfarë. Për të gjithë gjërat që i duhen Shkodrës, 700 lekë për familje. Kjo tjetra është ujë, se s’ka nevojë të dimë sa ka harxhuar finali ujë; po flasim për taksat, 780 lekë fletë, e gjitha bashkë. Thashë me vete ky që do jetë më i liri, kushedi si krahasohet me tonën. Ne i kemi më të specifikuar, kemi:

- tarife pastrimi 100 leke
- taksa e përkohshme e infrastrukturën arsimore 150 leke (Po ka qenë 150 lekë dhe në kohë të Lulit dhe se kam fare për turp, ka qenë dhe në kohë te Edit, ishte taksa e gjelbërimit, se bashkia blinte pemë)

Tani ne, meqë gjetëm pemët në këto mënyrat e tjera, do të flas dhe për atë te pemëve, ne vetëm atë taksë, i ndryshuam targën, pra është e njëjta makinë. Por nuk e çojmë te pemët, por i çojmë për të bërë këto 40 shkollat, dhe jemi shume krenare

I thonë 100 lekë pastrimi + 150 lekë kjo, 250 lekë. Dhe është dhe taksa mbi ndërtesën. Kjo është sipas metrave katrore. Kjo ka qëlluar shtëpi e madhe, shumicës i bie 100 lekë, por këtij i ka shkuar 234 lekë. Në total 484 me 708, pra bashkia e Tiranës, për taksat dhe tarifat familjare, nuk flas për

**Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë
Tiranë, datë 19.04.2023**

dikë që bën kulla, se po të ishte vend që ka prokopi dhe ndërtohej mire dhe ishte i pastër, do plasnin kullat dhe në Shkodër, ju garantoj për këtë, dhe ata s' do i bënin naze, por vetëm ngaqë ikin e nuk shkon njeri.

Tani krahasoni: pra, mbledh nga familjarët 784, dhe nuk bën dot as linjën e autobusit falas.

I rest my case. Kjo është llogaria.

Dhe problemi që ne kemi, o shokë dhe vëllezër dhe motra, është që këtu kemi dhe një krizë të madhe në gazetari. Dhe flas shumë me gazetarë, me shumë panele e thonë “Kryetar, po ne duhet ti ballafaqojmë të gjitha palët, dhe për ne liria e shprehjes do të thotë të dëgjojmë dhe këtë dhe atë”.

Tani, n.q.s. njëri thotë që toka është rrumbullakët dhe tjetri të thotë që toka është e sheshtë, kjo është barazi opinionesh? Se n.q.s. **njëri po thotë idiotësi me okë**, detyra e gazetarit nuk është “fole ti, foli dhe ky”. Detyra është të thuash kush tha një gomarllëk, që ne themi “aaa toka është e sheshtë”. N.q.s. ti fton dy mjekë, dhe njëri të thotë që vaksina shpëton jetë dhe tjetri të thotë që në vaksina ka futur chips Steve Jobs; detyra jote si gazetar nuk është “i dhamë mundësi të dyja palëve”. Detyra jote është që ti thuash atij tjetrit, ooo shoku, po përdor kohë televizive që transmetohet në valë publike. Dhe ti në valë publike nuk mund të bësh avokati kundër shkencës, dhe të shpërndash idiotësi që marrin njerëzit në qafe, dhe të përfundojnë në Sharë dhe ne Tufinë.

Kur ti ke dy në panel që thonë 1-“ sot bën furtune dhe është shi dhe tjetri thotë është diell, ti nuk mund të thuash i dëgjova të dyja palët. Detyra jote si gazetarë është të hapësh dritaren, ta shohësh çka moti është, dhe njërit ti thuash “po, është me diell” dhe tjetrit ti thuash “mos gënje, nuk ka shi. Kështu që dhe kjo historia që këtu nuk verifikohet asnjë, dhe këtu jam fajtor vet te ky rast. Pra merrja të mirëqenë, se kur e sheh Shkodrën aq pis, aq të shkatërruar, aq të degraduar, ti thua me vete rrezik mbledhin pak. Por jo, zotëria mbledh 708 lekë për familje, kurse ne 484

Ajo që po përpiqem të them, është shumë e rëndësishme që ne të përpiqemi të jemi avokatë të së vërtetës. Ne duhet të bëjmë më shumë punë, në kohë më të shpejtë, me cilësi më të lartë, me më pak para. Kjo nuk është çështje logosh partie, kjo është çështje menaxhimi. Qartazi ata nuk kanë një qytet që mund të na thonë “Ne dimë të menaxhojmë”, dhe qytetin e vetëm që kanë, e kanë thuajse me dyfishin e taksave të Tiranës. Ta dëgjojë njeri më Shkodër këtë bisedë, që paguajnë më shumë taksa se në Tirane, dhe jetojnë si në botën e tretë, jo më autobusë falas, por këta do kishin turp të dilnim nga shtëpia e tyre të bënin fushatë. Dhe më duket se ka funksionuar, **që nga ajo vakia te stadiumi, që e nxorën atë pensionistin aty vetëm**, duke i fol karrigeve, kanë 3-4 ditë vetëm bëjnë kështu nëpër tik tok, nuk dalin nga zyra. Dhe duhet me i thënë, çojani një mesazh kur ti keni përballë “Dilni në fushatë, se është shumë e rëndësishme që të bëjmë debat”. Po kalojnë të tretat e stadiumit, dhe po e trajtojnë si një vaki, të 3-tat, të 7-tat, imagjinoni kur të vijnë të 40-at e atyre. Kështu që vërtetë është turp të identifikohet **me Saliun dhe Ilir Metën, dy kufoma, dy vjetërsira, dy rraqe, dy rrënoja morale të vendit tonë**. Por këta që janë kandidatë duhet të dalim çik nga shtëpia se kaloi vakia, ndodhi ca ndodhi, kishte më shumë njerëz për Ilir Metën, se sa për Sali Berishën, çfarë turpi për ta mbyll karrierën në atë moshë.

Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tiranë, datë 19.04.2023

Megjithatë, vendimi që marrim sot, ka të bëjë me shpërndarjen e aboneve. Ndodhën dhe ca momente që nuk janë politike; edhe pse aboneja e studentit është falas, shkojnë të gjithë në datë 30-31, nxitojnë për ta marrë.

Dhe ne që nuk jemi studente, themi të na gjejë viti i ri plot, dhe o burraa, të nxitojmë të dyndemi se mbyllen dyqanet. Bli mall kot, sikur nuk do hapet mini market/supermarketi te lagja dhe në datë 1 dhe në datë 2, kështu që një pjesë është kulturore. Ajo që na ka ndodhur është që te pikat, edhe pse është falas, ka një dyndje, sidomos orën e fundit.

Dhe sot me këtë vendim e merr bashkia përsipër shpërndarjen e aboneve, kjo do të thotë që do ta ofrojmë në më shumë pika. Pastaj çdo linje sipas aboneve që janë shitur, që janë 16.000 e përgjithshme ose 9.000, dhe jo 52.000

Kur dëgjoj këta dhëndrat tanë që thonë “taksën e tabelës për bizneset do e bëjmë falas”.

Kemi një 8 vjet që është falas. Dhe kur thonë që “Erjoni kur tregon këto batutat, është duke bërë batutë me Edi Ramën.” Me duket dhe vet e kanë harruar që mes Edit dhe meje ishte Lul Basha 4 vjet. Pra, partia e tyre e ka harruar që ishte dhe dikush tjetër mes nesh. Pra në këtë sens, unë besoj që është shumë e rëndësishme të kalojmë këtë vendim, edhe për të zgjidhur qoftë edhe këtë ngërç kulturor të dyndjes vetëm në sekondë të fundit, ndërkohë që ne gjatë gjithë muajit kemi abone, dhe gjithmonë ngelen stock, nuk është se ikin të gjitha. Dhe për faktin që sot ka më shumë interes për studentet tani që aboneja është lënë falas.

Këtë vendim e merr përsipër bashkia për distribucionin e aboneve dhe secilës linjë ti japim pjesën e vet.

Ndërkohë dua që t’ju përmend përveç këtyre gjërave të aboneve, ne do të bëjmë edhe të gjithë reformën e transportit publik. E kemi bërë një draft të parë, jemi duke pritur nga kolegët gjermanë dhe britanikë detajimin dhe për linjën e unazës, dhe për linjën e Tiranës së re, dhe për linjën e kombinatit. Dhe unë besoj që më mirë të themi të vërtetën, se do kthehemi prapë në datë 15 këtu dhe të vazhdojmë punën, se sa të gënjejmë. Është ajo që thonë tironsit “Po të plasi cipa, çdo gjë është e lehtë”. Pra po rrejte dhe e di që nuk bën gjë e s’mund të mbash ndonjë premtim, ti mund të thuash budallalliqe me okë. **Po si mund të thuash “Unë do ul taksat”, ndërkohë I kemi më të ulëta se Shkodra, pra, I kemi më të ulëta se qyteti që është keqtrajtuar më shumë nga bashkitë e Shqipërisë. Si mund të thuash “Do ulim taksat, por do rrisim shpenzimet”, pra, nuk do ketë më taksë ndërtimi, do heqim dhe 1/3 e taksave të tjera.** Kësaj I thonë petulla me ujë, se si do t’i taksosh të gjithë njerëzit, që vetëm një pjesë ta ketë falas, nga taksimi I përgjithshëm I atyre që janë si me makinë, si me këmbë ose me biçikletë, që kjo është fyerje, se I bie të paguajë dikush që nuk merr shërbim. Dhe tjetra, si do e bëjmë këtë duke I ulur të gjitha taksat, kur sapo e provuam që jemi shumë më poshtë se sa Shkodra. Petulla me ujë, se të bësh më shumë petulla, duhet më shumë brumë, të bësh më shumë djathë, duhet më shumë qumësht. Kjo historia që këta bëjnë tortë me qumësht pluhur, dakord, por e mbyllin me turp. Kapin të gjithë nga një legen, nga një gotatë tortë, por mbaron shpejt dhe të skuq fytyrën.

Kështu që në këtë sens, e zgjidhim dhe anomalinë e dyndjes në pikat e shërbimit, duke e marrë bashkia dhe duke e ofruar këtë shërbim në më shumë pika, përfshirë dhe Tirana Park dhe të gjitha

**Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë
Tiranë, datë 19.04.2023**

ato kioskat tona, ku ne kemi mundësi që ta ofrojmë shitjen e abonësë, dhe të çlirohet pak edhe ai fluksi I atyre ditëve të fundit të muajit.

Në finale kemi dhe disa vendime që janë në lidhje me pronat tona. Po hapim një garë, për të ofruar shërbimet e kateringut te Aquadrom, aty ku ne kemi marrë tashmë pishinat, ja kemi kthyer Federatës së Notit, kemi marrë fushat e kalçetos, po ja kthejmë shoqatave sportive. Që tani është evidente në fakt, që verën që kaloi filloi të ishte evidente që e menaxhonim më mirë se sa privati, dhe besoj që tani që I kemi të gjitha mundësitë, edhe për të organizuar aktivitete, dhe për të dhënë hapësirën nëse dikush do të bëjë një ditëlindje, apo një dasmë, apo një ceremoni. Pra ta kthejmë rentabël një pronë që është në mes të Tiranës, e cila deri dje abuzohej për lavazh dhe për gomisteri dhe pishina ku zhytshim. Ajo pishina olimpike ishte kthyer në një landfill të madh për rraçe. Ndërkohë, jemi duke punuar dhe do t'ju vijmë me propozime edhe për atë që ne duam të bëjmë me stadiumin Selman Stërmasi, dhe me pallatin e sportit Asllan Rusi. Ndërkohë, bashkia e mori një vendim për parkun sportive kompleksin Dajti, që është te universiteti I sporteve, që besoj duhet të jetë në fazën e apelimit të konkurrentëve, për të parë kush është fituesi, për të filluar punën atje. Dhe pastaj gara për stadiumin dhe pallatin e sporteve, nuk bëhet fjalë të bëjmë arenën kombëtare, pra, do të jetë më modeste. Ai I lojërave me dorë, 4000-4500, pra 2-afishimi I asaj që kemi. E njëjta gjë dhe me stadiumin Selman Stërmasi, patjetër me më shumë kapacitet, por nuk bëhet fjalë për një 22.000 vendësh. Bëhet fjalë për të krijuar një pol te njësia 5, ku edhe Sport Club Tirana, edhe Futboll Club Tirana të kenë ambientin e tyre, por ama të jetë dhe një pikë që injekton ekonominë në atë hapësirë. Duam që të likuidojmë një kompani që quhet super beton, që në vitet '90 e krijuar në mes të bashkisë dhe italianëve, që kishin një nyje betoni në atë hapësirë. Ai është një terren që sot më shumë se sa prodhim I betonit, vlen terreni. Dhe duke qenë se është në kampusin e madh të Rruga 5 Maji, praktikisht ne na vlen më shumë të marrim % tonë të tokës në metra katrorë, dhe ti japim për banesa sociale ose për ata që po kompensohen prej tërmetit, sesa të mbajmë një hapësirë që, deri dje, konsiderohej fundi I botës, ishte te bregu I lumit, por sot është bërë epiqendër e zhvillimit. Dhe për sa kohë nuk ka aktivitete ekonomik fare, pra thjesht kompania në asetet e veta ka vetëm këtë tokë, edhe ne dhe italianët me këtë vendim, I japim dorë njëri tjetrit. Ne jemi 30% aksionerë, atëherë duam të marrim 30% të çdo gjëje që do bëhet në atë pronë, sipas ligjeve në fuqi. Dhe, sigurisht, përqindjen tonë ne do ta përdorim për këto kauza ku kemi nevojë për strehim social, ose për kompensim, të atyre që mund të kenë ndërtuar në terrenin e 5 Majit, por që tani do të marrin pallatet e reja.

Projekti tjetër ka të bëjë gjithashtu me një shqyrtim propozimi, me një tjetër kompani që ne kemi, prapë me një grup italian. Bëhet fjalë për qendrën tregtare dhe të zhvillimit kulturor, është një SHPK, te Pallati I Kulturës. Kemi, nuk e di a e mbani mend, por kush është këtu që ka ndjekur politikën në vitet 90, ishte si historia e Saliut, që s'kishte para të paguante rrogat, dhe vajti e shiti Hotel Dajtin, shiti ca hidrocentrale, se I duheshin cash. Ndërkohë, kjo situatë ishte më e mirëkuptueshme në kohën e Z. Meksi, se atëherë vërtetë qeveria trashëgoi një shtet të falimentuar, dhe shumë prej këtyre aseteve, përfshirë dhe të Pallatit të Kulturës, u shit në investitorë italianë, që kanë patur ambiente zyrash e gjëra të kësaj natyre.

Ne duhet të japim dakordësi, italianët janë duke blere e shitur aksione. Ne jemi një nga aksionerët, jemi aksionerë te minorancës. Ne nuk kemi interes, në gjykimin tim, edhe te ekspertëve, që te përfshiheshim në transaksione mes tyre, sepse duam që bashkësia e Tiranës të transferohet te bulevardi I ri. Kështu që për sa kohë ne mbajmë zyrat tona dhe mbajmë % tonë, ne nuk kemi

**Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë
Tiranë, datë 19.04.2023**

interes të blejmë miliona euro zyra në qendër, në Pallatin e Kulturës, për sa kohë që po ndërtojmë një kampus për bashkinë te bulevardi I ri. Por është këshilli ai që duhet të shprehet, nëse ne duam të heqim disa milion euro tjetërkund, për të blerë zyrat e italianëve (thjesht për t'ia shpjeguar, pse është blerë në fillim nga italianët një pjesë e Pallatit të Kulturës. Po të shikoni, Instituti Italian I Kulturës, është pjesë e asaj qiramarrje dhe atij zhvillimi. Për t'i ilustruar, po ju quaj juve brezi I ri, çka ka ndodhur në vitet 90, dhe pse bashkia ka këtë marrëdhënie kontraktuale me këta zotërinj.

Pika tjetër që kam me merak të sqaroj, ka të bëjë me projekt-vendimin, ju e dini që çerdhet dhe kopshtet hapen me vendim të Këshillit Bashkiak pasi të marrin një licencë nga ministria e Arsimit. Bëhet fjalë për të hapur dy institucione për vogëlushët. Njëra është në Astir, te lagja 14, do të jetë çerdhe dhe kopshti i parë në atë komunitet. Edhe **I them këtyre shokëve që kemi përballë, ka një arsye pse na voton Astiri, në masën 64%. Se Astiri, me të drejtë thotë “Këta që bënë 40 shkolla, bëjnë e 44; këta që bëjnë 100 rrugë, bëjnë dhe 101; ata që s’kanë prek gjë me dorë dhe na lanë pa ujë pa kanalizime, pa arsim, e sigurt që nuk nxjerrin dot qimen nga qulli”**. Kështu që më vjen mire, që përveçse terreneve të reja ku do të hapim gare, ne kemi dhe çerdhen e parë që hapet, kurse çerdhe-kopësht do të hapet në Ndroq.

Sigurisht, numri i çerdheve që do të ndërtohen në Astir është më I madh, janë 326 fëmijë, numri i fëmijëve në Ndroq janë 41 fëmijë. Po këtu parimi nuk është kush është me I forte, apo shumica fiton, këtu parimi është “të gjithëve tu shërbejmë me të njëjtin standard”. Pra, me këtë vendim, ne hapim 1 çerdhe dhe 1 kopsht në Astir, dhe jemi gati të fillojmë, në mos javën tjetër, e sigurt brenda Majit, me institucionin e parë arsimor, edhe për të provuar cinikun më të madh, që përfaqësonte ata që e lanë shkretët, se si bëhet puna dhe se si organizohen projektet, por edhe për të filluar diçka të kësaj natyre në Ndroq, ku shërbimi është kërkuar nga 41 familje me 41 fëmijë.

Ndërkohë, kemi së fundi, një projekt që na ka ardhur në moment të fundit, po prapë, ky I çerdheve dhe kopshteve, ky I emërimit të rrugëve, nuk besoj që ha kritikë për diskutime në komisione. Bëhet fjalë për emërtimin e rrugëve...është një albanolog I shquar hungarez, ju e dini që ne kemi raport shumë special me Hungarinë, që nga koha e Skënderbeut. Por edhe ne si bashki e Tiranës, në fakt, asistenca jonë kryesore në çështjet e inxhinierisë së ujërave dhe hidrologjisë vjen nga ujësjellësi I Budapestit. Me ata kemi patur partneritetin kryesor. Na ndihmuan të dilnim nga falimenti, na ndihmuan që ta kishim ujin më të lirë se sa në Kamëz kur drejtohej nga këta shokët tanë. Pra, ata e kanë 67 lekë, ne e kemi 65 lekë, prandaj duhen kontrolluar se na del si kjo puna e Shkodrës. Që I paskemi patur taksat më të ulëta se Shkodra, dhe kemi bërë më shumë punë, është çështje menaxhimi . Dhe na bënë të aftë kolegët e Budapestit, që të ishim e vetmja bashki që ka një SHA, pra një agjenci ,një kompani publike, që te financojë direkt, pa garanci sovraane. Nuk ka sot ne Ballkan, Shqipëri jo e jo, po ne Ballkan, që financohet direkt nga institucionet financiare të zhvillimit: Banka Europiane e Investimeve. Jemi të vetmit, dhe kolegët hungarez na ndihmuan që të shëndoshim financat, disiplino ujësjellësin, ulim humbjet në rrjet, bëjmë investimet e zgjuara, dhe tani jemi në një situatë ku, kërkojmë respektin e kolegut hungarez, dhe nga Bashkia e Budapest dhe kolegët tanë të ujësjellësit ...

Këto ishin vendimet dhe ju falënderoj nga zemra për bashkëpunimin. Ju uroj një fushatë të qetë,

**Lidhja nr. 4 Transkript i fjalës së Z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit të Bashkisë
Tiranë, datë 19.04.2023**

të gjithë atyre që kandidojnë, të të gjitha forcave politike, sepse besoj që kemi mundësi ti japim për herë të parë Tiranës. **Disa parti, si e jona, ka zgjedhur këtë çështjen e investimit në gjelbërim dhe të mbjelljes së një peme, jo të mbjelljes së një sherri. Por më rezulton që në përgjithësi, pavarësisht diferencave që kemi, është një fushatë e qetë, më shumë në stadium bosh se sa në sherre kot. Kështu që për sa kohë dhe pala tjetër, me gjithë çudirat e fushatës, po e kalon relativisht qetë, unë besoj duhet të shkojmë kështu edhe këto tre javë, dhe pastaj, të mbyllim me një festë të demokracisë ditën e diel, dhe të hënën të kthehemi prapë në punë, për ta çuar Tiranën përpara”.**

Video e plotë: <https://fb.watch/k0lQicCtbp/>